



ZHVILLIMI I SEKTORIT PRIVAT



SHKURTIMISHT RRETH SEKTORIT

Zhvillimi i sektorit privat është shtylla e ekonomive të Ballkanit Perëndimor dhe luan rolin kyç në përafrimin ekonomik dhe anëtarësimin në BE. Si dhe në ekonomitë e tjera në tranzicion nën presionin fiskal në nivelin kombëtar dhe aftësinë e kufizuar paguese të kredisë në të gjitha zonat përveç qyteteve të mëdha, ndërmarrjet të vogla dhe të mesme (NVM) karakterizohen nga shkalla e ulët e konkurrencës, qasja e vështirësuar në financim, mungesa e aftësive dhe integrimi i dobët në zinxhirët globalë të furnizimit. Fokusi është në përmirësimin e qasjes në financim dhe mbështetjen e biznesit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nëpërmjet Programit të Zhvillimit dhe Inovacioneve të Ndërmarrjeve të Ballkanit Perëndimor (WB EDIF), iniciativës së përbashkët të BE-së, institucioneve financiare, partnerëve dypalësh dhe institucioneve publike në Ballkanin Perëndimor. WBIF gjithashtu, ka financuar edhe iniciativën EPEC e cila promovon punën me organet kyçe për partneritetin publiko-privat në rajon me qëllim rritjen e kapacitetit të tyre për identifikim, përgatitje dhe implementim të projekteve në fushën e partneritetit publiko-privat.


WBIF EDIF

WB EDIF u formua fillimisht me vendim të WBIF si një platformë e dedikuar për zhvillimin e sektorit privat me një strukturë dhe koordinim të veçuar. Në Dhjetor të vitit 2019, në sesionin e 21 të Bordit ekzekutiv të WBIF u vendos për riintegrimin e WB EDIF në WBIF.

WB EDIF siguron mbështetje përmes katër mekanizmave komplementare; (1) financimi i kapitalit të NVM-ve me të cilin ofrohen dy fonde të kapitalit të fokusuara tek kompanitë inovative në fazën fillestare të punës (Fondi për ndërmarrjet inovative) dhe ndërmarrjet tashmë të themeluara që janë në fazën e rritjes (Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve); (2) Kreditim i garantuar për NVM, i fokusuar tek punësimi i të rinjve, ofrimi i mbështetjes për bankat lokale në zhvillimin e biznesit të NVM-ve me ndarjen e riskut (nga ana e EIF-it) duke ulur kostot e huamarrjes; (3) Huadhënia për NVM duke siguruar linjat e posaçme kredie dhe asistencën teknike për institucionet financiare partnere dhe NVM; (4) Shërbimet e mbështetjes, të cilat përfshijnë shërbimet rregullatore dhe këshillëdhënëse me qëllim të mbështetjes së kapaciteteve të ndërmarrjes dhe fuqizimit të ekosistemit të biznesit.



GRANTET E WBIF SIPAS NËNSEKTOREVE

Nënsëktorët e sektorit privat (në mil. €)



Western Balkans Investment Framework **WBIF**
BUILDING THE EUROPEAN FUTURE TOGETHER


REZULTATET E ARRITURA



GRANTET E WBIF SIPAS PËRFITUESVE

Vlera e granteve (në mil. €)

Numri i granteve





ZHVILLIMI I SEKTORIT PRIVAT



NVM në fokus: Koshi Group sh.p.k., Kosovë



Koshi Group sh.p.k. është prodhues i komponentëve prej fibrave të karbonit me seli në Prizren, në krye të të cilit është Shkamb Koshi, ndërmarrës i ri me mbi 10 vjet përvojë në industrinë automobilistike në Itali. Edhe pse sektori automobilistik është fusha kyçe e biznesit të tyre, kjo kompani zgjeron prodhimin edhe në industrinë mjekësore dhe atë të modës me materialet e krijuara nga kevlari dhe hoja. Sot kompania eksporton të gjitha produktet e saj në tregjet e BE-së, ndërsa portofoli i klientëve përfshin kompanitë prestigjioze siç janë Fiat, Abarth, Alfa Romeo, Ferrari dhe Porsche. Që nga themelimi, Koshi Group ka treguar sukses në rritjen e xhiros nga viti në vit, duke arritur maksimumin prej 65,000 eurosh gjatë vitit të parë të biznesit dhe duke realizuar 727,973 euro gjatë vitit të katërt të biznesit. Duke ndërtuar mbi rritjen e përmendur të të ardhurave, bashkë me një kërkim gjithnjë në rritje, kompania ka hartuar një plan për të rritur kapacitetet e prodhimit dhe ofruar kushte më të mira pune për punonjësit e tyre. Gjatë vitit 2018 kompania ka marrë ndihmë këshilluese në kuadër të WB EDIF për projektimin e fabrikës së re të prodhimit në përputhje me standardet e BE-së, gjë që përfshinte gjithçka nga hartimi i planit të arkitektit deri te shpenzimet e detajuara të investimit. Si rezultat i projektit, komuna e Prizrenit ia ka miratuar kompanisë lejen ndërtimore. Drejtuesit e kompanisë shqyrtojnë mundësinë e marrjes së mbështetjes këshilluese shtesë për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, të bazuar në ISO.



Shembull i produktit të kompanisë (C) EU



Shembull i produktit të kompanisë (C) EU